

Të nderuar qytetarë, lexova programin e qeverisë për 4 vjetët e ardhshëm. Megjithëse koha që kisha në dispozicion ishte shumë e shkurtër, mendova të shpreh shkurtimisht mendimin tim në lidhje me këtë program. Programi fillonte me frazën: “Qeverisja nuk është zanat, por mandat i deleguar nga populli për ta ngjitur vendin më lart në shkallën e zhvillimit.” Sa mirë sikur të ishte vërtet mandat i deleguar nga populli, do të ishte shumë qetësuese për mua dhe për mbarë popullin. E them këtë, pasi më kujtohet fushata elektorale që sapo lamë pas, më kujtohet presioni që u ushtrua mbi zgjedhësit, më kujtohet përdorimi i administratës në këto zgjedhje, më kujtohet që Partia Socialiste, e cila çmon suksesin e ashtuquajtur në performancën elektronike të qeverisjes, ishte po ajo që shfrytëzoi shtetasit shqiptarë me përdorimin kriminal të të dhënave personale, si formë e ushtrimit të presionit ndaj qytetarëve dhe ofrimit të favoreve shtetërore në këmbim të votës. Të dhënat konfidenciale të qytetarëve u cenuan dhe u lanë në duart e sistemit patronazhist. Më kujtohen edhe shumë elemente të tjera të kësaj natyre, por seanca e sotme nuk ka për objekt këtë temë. Si fillim po analizoj fare shkurt disa nga pikat, që hapnin programin qeverisës të kabinetit “Rama 3”.

Rimëkëmbje e ekonomisë nga tërmeti dhe pandemia Shqipëria u gjuhëzua përballë tërmetit të datës 26 nëntor të vitit 2019, ku, për fat të keq, pati 51 viktima, si dhe shumë ndërtesa të cilat u shkatërruan dhe të tjera që u cilësuan si të pabanueshme. Kjo ngjarje tregoi faktin që sot Shqipëria gjendet e pambrojtur dhe e papërgatitur për emergjencën. Ndërmjet të tjerash ishte zona e Thumanës, Fushë-Krujës dhe Bubqit, të cilat kishin dëmtime të thella. Për shumë veta tërmeti ishte një fatkeqësi, por në sytë e rilindjes ishte një metodë tjetërsimi e votës së qytetarit, e cila u dëshmuar me propagandën që i ka bërë këtij procesi. Njerëzit jetojnë akoma nëpër çadra. Kanë kaluar 2 vjet nga tërmeti dhe pandemia dhe më shumë ka demagogji, propagandë, foto dhe video sesa punë. Shtëpitë e ndërtuara në Fushë-Krujë dhe kudo, nuk flas për pallatet dhe as për ndërtimet e kryera nga pala turke, janë totalisht jashtë standardeve. Mjafton të krahasoni ndërtimet e realizuara nga pala turke me të gjitha ndërtimet e tjera dhe do të vini re ndryshimin. Mirëqenie për të gjithë, që do të përkthehet në një ekonomi të zhvilluar, që krijon shanse për të gjithë. Këto janë pesë elementet që përbëjnë ekonominë në Shqipëri, në gjykimin tim. Në kuptimin që, nëse duhet të fuqizojmë ekonominë shqiptare, mjafton të përqendrohemi në këto drejtime dhe besoj se do të jemi shumë mirë. Industria e kromit Di, dhe më vjen keq, që vdesin njerëz çdo muaj nëpër miniera. Jemi ndër të paktat shtete në botë, unik, që eksportojmë mineralet dhe shumë produkte të tjera bruto dhe importojmë nënproduktet e tyre, kuptohet që i shesim një lek dhe i blejmë tre lekë të përpunuara. Dy uzina ferrokromi ka Shqipëria, në Burrel dhe në Elbasan, asnjëra nuk përdoret. Karburanti Mjafton t’i referohemi faktit se jemi një nga vendet me çmimin më të lartë të karburanteve në Europë dhe në botë. Theksoj faktin se në strukturën e çmimit të karburanteve që tregtohen sot në Shqipëri, vetëm 29% të totalit e përbën çmimi, ndërsa pjesa tjetër, prej 71%, janë taksa si: akciza, taksa e karbonit, taksa e qarkullimit, marzhi i fitimit, taksa e markimit, TVSH-ja. Edhe këtë produkt, ari i zi quhet ndryshe, preferojmë ta shesim bruto dhe ta importojmë të përpunuar.

Vendi ynë është një nga vendet që e ka bekuar Perëndia me shumë burime energjie, por që çuditërisht edhe sot, pas 30 vjetësh, vuajmë shumë në këtë drejtim. Duke përjashtuar deri diku Tiranën, në të gjithë vendin ndërprerjet e energjisë janë të shumta, si dhe problem akoma më i madh është fuqia e energjisë që nuk furnizohet brenda normave të lejuara. Kjo jo vetëm që nuk është e lejueshme, por

është e dënueshme, pasi sjell dëme të mëdha te konsumtaori final. Të gjitha riparimet e rrugëve në bregdet dhe aksionet e IKMT-së në Shqipëri fillojnë në muajin maj dhe mbyllen në shtator dhe mua personalisht më duket si sabotim. Bujqësia Ky sektor do ende kohë të marrë veten. Edhe bujqësia do të ishte prioritet po t'i referohemi gjeografisë së vendit tonë, por gjendja e saj sot lë shumë për të dëshiruar. Unë vij nga zona e Fushë-Krujës, zonë e cila është përbytur disa herë bashkë me rrethinat e saj. Zona ime në dimër përbytet dhe në verë vuan nga mungesa e ujit për vaditje. Lumi Zezë, lumi i Gjolës dhe Ishmit kanë përbytur toka, që nuk përbyteshin para vitit 2013 dhe asnjë lloj kompensimi nuk është bërë për këto zona sa herë që ato përbyten. Familja, themeli ku ndërtojmë të ardhmen.

Familja shqiptare është në ditën e saj më të zezë. Po vriten gra çdo ditë dhe ritmet e emigracionit rriten. Afërsisht 35% e studentëve me një diplomë Bachelor dhe rreth 30% e studentëve në përgjithësi synojnë të studiojnë jashtë vendit, ndërsa niveli i gjendjes ekonomike të studentëve shqiptarë është sërish në përmasa alarmante krahasuar me vendet e tjera. Largimi i të rinjve nga vendi kap shifra deri në 79%, duke e vendosur Shqipërinë në krye të listës së vendeve nga ku largohen të rinjtë. Shqipëri e fortë, me shtet të fortë, vëmendje për çdo shqiptar dhe me dinjitet në botë. Kush jeton në Shqipëri, e di fort mirë se sa qesharake tingëllon kjo fjali. Një shtet ku kriminelët më shpejt dalin nga burgu se sa futen, në një shtet ku siguria është zero, në një shtet ku femrat vriten si pa të keq, nuk e kuptoj ku e shikon qeveria shtetin e fortë dhe me dinjitet në botë. E vetmja gjë që bën mirë kjo qeveri është fryrja e administratës. Pësia e administratës publike në ekonomi është rritur ndjeshëm në 15 vjetët e fundit, duke e shndërruar atë ndër sektorët kryesorë, sidomos në punësim. Rritja e peshës së administratës në ekonomi nisi gradualisht pas vitit 2013. Edhe pse politikat qeverisëse kanë premtuar një administratë të vogël, me pak ministri dhe me shkrirjen e disa enteve publike, në realitet numri i punonjësve në administratë është zgjeruar. Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë për vitin 2021 është 83749 punonjës, sipas ligjit nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", neni 12 i tij. Sipas burimeve jo zyrtare thuhet që ky numër do të rritet akoma më tej në vitin 2022.

Në mbyllje duhet të them se ajo që më ra më shumë në sy në hapjen e këtij programi është se nuk flitet asnjë fjalë për arsimin, e kam fjalën për arsimin si prioritet, pasi në brendësi e pashë që flitej për të. Gjithsesi, e thotë edhe Fan Noli tek poema "Sulltani dhe kabineti": "Ti Halim që s'di këndim/ Je vezir për arsim". Ka mbi dy vjet që në Shqipëri nuk zhvillohet mësim. Pavarësisht propagandës që jeni të detyruar të bëni dhe të mbronni, të gjithë ndiejmë keqardhje për fëmijët, nipat dhe mbesat, që po bëjnë plot dy vjet pa mësim. Përfitimi nga mësimin online, le ta besojë kush të dojë, për hir të partisë që përfaqëson apo për hir të liderit, në praktikë dhe thellë-thellë të gjithë jeni të bindur që është zero. Faleminderit!